




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Date: 23/05/2024

Nr/02/470

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në pajtim me nenin 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, në përkujdesje të interesit publik dhe në funksion të garantimit për zbatim të dyanshëm të marrëveshjeve me përfituesit e pronave publike si dhe në respektim të rekomandimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni komunal për vlerësimin dhe shqyrtimin e zbatueshmërisë praktike të marrëveshjeve me palët (persona fizik dhe juridik) përfituese të shfrytëzimit të pronave publike në Komunën e Shtimes.

2. Anëtarët e Komisionit sipas pikës 1 të dispozitivit caktohen:

1. Kastriot Shabani – Kryesues
2. Bajrush Rrahmani – Anetar
3. Besnik Ahmeti – Anetar
4. Gezim Brahaj – Anetar ne cilesine e vleresueist – ekspert i jashtem
5. Hamide Hoxha - Anetare

3. Anëtarët e Komisionit i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në pajtim me parimet e legjislacionit në fuqi dhe përkujdesen për analizimin e shkallës së përmbajtjes në aspekt të përmbushjes së marrëveshjeve mes Komunës dhe përfituesve të pronave publike.

4. Mandati i Komisionit është i vlefshëm deri në përgatitjen përfundimtare të Raportit sipas qëllimit të këtij Vendimi dhe i njëjti i dorëzohet Kryetarit të Komunës.

5. Obligohet administrata komunale e Komunës së Shtimes për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Arkivit

